

1. Informacion i përgjithshëm

Romano Port sh.a, është një shoqëri e regjistruar më 19 prill 2005 si shoqëri aksionare. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj si dhe nga ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria ka NIPT K516255010. Selia e shoqërisë është tek Porto Romano, 500 metra në veri të Hidrovorit, Durrës, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 597,686 aksione me vlerë nominale 1,000 LEK për një vlerë totale 597,686,000 LEK. Aksionerët e shoqërisë janë:

- 1- Piro Bare me 99.84 % të aksioneve.
- 2- Florenc Gjiguria me 0.06% të aksioneve.
- 3- Xhevat Rira me 0.08% të aksioneve.

Administrator i shoqërisë është Z. Piro Bare.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ndërtimi, shfrytëzimi i portit, shkarkime dhe analiza të lëndëve djegëse, ruajtje objekti, përdorimi i mjeteve detare. Në vitin 2019 shoqëria ka vazhduar operimin e saj duke ofruar shërbimin e shkarkimit të naftës dhe benzinës. Ky investim është një konçension për 30 vite, i dhënë nga qeveria shqiptare me të drejtë ripërtëritje.

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2019 është 63 (2018: 62).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKKP) dhe ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Gjykimet dhe vlerësimet kontabël

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EURO/ LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Trajtimi kontabël për marrveshjen e konçesionit

Shoqëria ka zbatuar SKK 13 "Aktivet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare" për njohjen e kontratës së konçesionit pasi konçesiondhënësi kontrollon ose rregullon se çfarë shërbimesh të infrastrukturës duhet të kryejë operatori, kujt duhet t'ia kryejë ato dhe me çfarë çmimi. Gjithashtu konçesiondhënësi kontrollon çdo interes të konsiderueshëm të mbetur në infrastrukturë në fund të afatit të marrëveshjes. Shoqëria ka njohur një aktiv jomaterial në masën që i jep atij të drejtën (liçencën) për t'ia tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Një e drejtë për t'ia faturuar shpenzimet përdoruesve të shërbimit publik nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare, sepse shumat janë në varësi të shkallës së përdorimit të shërbimit nga publiku. Kategoritë e ndërtesave dhe makinerive dhe pajisjeve janë objekt i SKK 13.

iv. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit për vitin 2018 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit ne %
Ndërtesa (jo me konçension)	5%
Makineri dhe pajisje (jo me konçension)	5% dhe 20%
Pajisje informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete transporti	20%

Kategoria e AAJM-ve me konçension	Jetëgjatësia
Ndërtesa me konçension	10-30 vite
Makineri dhe pajisje me konçension	5-30 vite

v. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm shumës së humbjes.

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në arkë	31,992	95,304
Mjete Monetare në bankë	7,716,464	1,169,583
	<u>7,748,456</u>	<u>1,264,887</u>

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë për fatura të lëshuara	9,561,908	6,229,822
	<u>9,561,908</u>	<u>6,229,822</u>

7. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	4,444,252	248,515
Llogari të tjera të arkëtueshme nga palët e lidhura	5,846,688	5,846,688
	<u>10,290,940</u>	<u>6,095,203</u>

8. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim mbi fitimin	18,265,042	10,351,642
TVSH në doganë	294,069	294,069
TVSH e arkëtueshme	3,398	3,398
Të tjera kërkesa	6,852,908	29,047,694
	<u>25,415,417</u>	<u>39,696,803</u>

9. Inventari

Inventari paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lëndë e parë	31,991,385	32,677,784
	<u>31,991,385</u>	<u>32,677,784</u>

10. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	53,267,419	2,174,623
	<u>53,267,419</u>	<u>2,174,623</u>

11. Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Të arkëtueshmet nga të ardhurat e konstatuara më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura të konstatuara të paarkëtuara	58,014	58,014
	<u>58,014</u>	<u>58,014</u>

Romano Port sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

12. Aktive afatgjata materiale dhe të marra me koncesion

	Ndërtesa (me konçension)	Makineri dhe paisje (me konçension)	Total AAJM (me konçension)	Automjete	Të tjera	Aktive në proces	Total AAM	Totali AAM dhe AAJM me konçension
Kosto								
Gjendja më 1 janar 2018	2,957,537,946	1,041,563,765	3,999,101,711	37,502,940	10,188,585	6,486,916	54,178,441	4,053,280,152
Shtesa	29,770,835	1,686,334	31,457,169	-	33,050	787,292	820,342	32,277,511
Transferime	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	(259,070)	(259,070)	(2,047,050)	-	-	(2,047,050)	(2,306,120)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,987,308,781	1,042,991,029	4,030,299,810	35,455,890	10,221,635	7,274,208	52,951,733	4,083,251,543
Shtesa	14,820,703	2,739,043	17,559,746	-	242,417	-	242,417	17,802,163
Transferime	4,357,760	100,000	4,457,760	-	-	(4,457,760)	(4,457,760)	-
Pakësime	(51,709,046)	-	(51,709,046)	-	-	-	-	(51,709,046)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,954,778,198	1,045,830,072	4,000,608,270	35,455,890	10,464,052	2,816,448	48,736,390	4,049,344,660
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 1 janar 2018	692,839,735	510,133,961	1,202,973,696	8,921,302	5,579,562	-	14,500,864	1,217,474,560
Amortizimi i vitit	114,094,671	49,064,680	163,159,351	5,716,327	976,762	-	6,693,089	169,852,440
Pakësime	-	(135,314)	(135,314)	(634,586)	-	-	(634,586)	(769,900)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	806,934,406	559,063,327	1,365,997,733	14,003,043	6,556,324	-	20,559,367	1,386,557,100
Amortizimi i vitit	109,477,702	42,222,388	151,700,090	4,290,569	807,210	-	5,097,779	156,797,869
Pakësime	(9,089,546)	-	(9,089,546)	-	-	-	-	(9,089,546)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	907,322,562	601,285,715	1,508,608,277	18,293,612	7,363,534	-	25,657,146	1,534,265,423
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,180,374,375	483,927,702	2,664,302,077	21,452,847	3,665,311	7,274,208	32,392,366	2,696,694,443
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,047,455,636	444,544,357	2,491,999,993	17,162,278	3,100,518	2,816,448	23,079,244	2,515,079,237

Romano Port sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

13. Huatë

Balanca e huave në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 0 Lek. Shoqëria ka shlyer detyrimin e huasë të vitit 2018 me vlerë 5,457,478 Lek.

Në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 balanca e huasë është si më poshtë:

Huadhënësi	Lloji huasë	Data e marrjes se Huasë	Data e Shlyerjes se huase	Afati	Monedha	Shuma e principalit ALL	Balanca e Mbetur	Shuma për t'u shlyer deri		Balanca e Mbetur	Shuma për t'u shlyer deri	
								në 1 vit	mbi 1 vit		në 1 vit	Afati
Nga Bankat												
Intesa San Paolo	Kredi	01.06.2008	31.12.2018	10 Vjet	EUR	5,000,000	-	-	-	-	-	-
Tirana Bank	Kredi	01.06.2008	31.12.2018	10 Vjet	EUR	2,000,000	-	-	-	-	-	-
Abi	Kredi	01.06.2008	31.12.2018	10 Vjet	EUR	3,475,000	44,219	5,457,478	-	44,219	44,219	-
							44,219	5,457,478	-	44,219	44,219	-

Romano Port sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

13. Huatë (vazhdim)

Huatë afatshkurtra detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua afatshkurtër (Principal viti pasardhës)	-	5,457,478
Interesa të llogaritura	-	9,353
Hua afatshkurtër Overdraft	-	11,604
Detyrime për qira financiare	-	-
	<u>-</u>	<u>5,478,435</u>

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për fatura të pranuar	267,388,626	446,830,192
Furnitorë për fatura të pambërritura	527,083	650,479
	<u>267,915,709</u>	<u>447,480,671</u>

15. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura	114,867,770	128,582,252
Llogari të pagueshme të tjera ndaj palëve të lidhura	608,261,779	523,395,505
	<u>723,129,549</u>	<u>651,977,757</u>

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	817,342	858,210
Detyrime për TAP	235,661	250,532
TVSH për t'u paguar	1,372,608	8,741,709
	<u>2,425,611</u>	<u>9,850,451</u>

17. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga për t'u paguar	-	5,000
	<u>-</u>	<u>5,000</u>

Romano Port sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

18. Provizione afatgjata

Provizione afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Provizione në fillim të vitit	121,294,730	121,294,730
Shtesa	-	-
Rimarrje	-	-
	<u><u>121,294,730</u></u>	<u><u>121,294,730</u></u>

19. Hua të tjera afatgjata

Huamarrje të tjera afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Huamarrje të tjera afatgjata	31,856,140	32,208,221
	<u><u>31,856,140</u></u>	<u><u>32,208,221</u></u>

20. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërisë është 597,686,000 LEK i zotëruar nga aksionerët si vijon:

	<u>31 dhjetor 2019</u>			<u>31 dhjetor 2018</u>		
	Aksionet	Vlera nominale	%	Aksionet	Vlera nominale	%
Piro Bare	596,786	1,000	99.84%	596,786	1,000	99.84%
Xhevat Rira	500	1,000	0.08%	500	1,000	0.08%
Florenc Gjiguria	400	1,000	0.06%	400	1,000	0.06%
	<u><u>597,686</u></u>		100%	<u><u>597,686</u></u>		100%

Shoqëria ka humbje më 31 dhjetor 2019 në vlerën (9,805,277) LEK (2018: 86,352,195 LEK).

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shitje neto	284,994,200	595,700,058
	<u><u>284,994,200</u></u>	<u><u>595,700,058</u></u>

(Vlerat janë në Lek)

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Qarkullim i tatueshëm	288,737,026
Shtohen efektet e kursit të këmbimit	1,430,207
Shuma e qarkullimit e korrektuar	290,167,233
Sipas Kontabilitetit	290,167,233
Diferenca	-

22. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar, rezultatit nga shitja e AAM-ve dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Nga shitja e materialeve dhe mallrave	1,725,490	2,387,358
Të tjera të ardhura nga shitja e shërbimeve - Qera	1,467,987	1,840,941
Të ardhura nga shitja e inventarit	549,349	-
Rezultati nga shitja e AAM-ve	-	13,865
Rezultati nga kursi i këmbimit	1,430,207	2,484,041
	5,173,033	6,726,205
	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Rezultati nga shitja e AAM-ve		
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	-	137,623
Vlera kontabël neto e AAM-ve të shitura	-	(123,758)
	-	13,865
Rezultati nga kursi i këmbimit		
Të ardhura nga kursi i këmbimit	2,223,058	2,639,647
Humbje nga kursi i këmbimit	(792,851)	(155,606)
	1,430,207	2,484,041

23. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Materiale të para	1,476,877	8,481,178
Lëndë ndihmëse	172,727	-
Lëndë djegëse	5,483,716	-
	7,133,320	8,481,178

(Vlerat janë në Lek)

24. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Blerje energji, avull, ujë karburant	3,297,398	4,283,590
Mirëmbajtje dhe riparime	58,300,160	233,775,756
Prime sigurimi	469,663	379,147
Shpenzime të ndryshme	3,103,322	4,929,065
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,713,273	1,176,272
Komisione bankare	156,499	161,452
Taksa të ndryshme	213,133	262,269
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	223,445	62,710
Vlera kontabël neto e asetëve të nxjerra jashtë përdorimi	-	1,412,462
	<u>67,476,893</u>	<u>246,442,723</u>

25. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime paga	42,073,581	41,982,870
Shpenzime për sigurime shoqërore	6,058,893	6,087,918
	<u>48,132,474</u>	<u>48,070,788</u>

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2019 është 63 (2018: 62). Lista e punonjësve e ndarë sipas kategorive është si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Administrator	1
Financa dhe specialistë	5
Staf i anijeve	14
Staf operacional	43
	<u>63</u>

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjopa të ndryshme	61,296	986,469
	<u>61,296</u>	<u>986,469</u>

27. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të Shoqërisë. Ky zë detajohet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime të tjera interesash	-	1,940,935
Shpenzime për interesa palë të lidhura	19,600,896	30,615,381
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit për aktivitetin financues	769,762	(5,977,810)
	20,370,658	26,578,506

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	(9,805,277)	102,014,159
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	61,296	2,398,931
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	61,296	986,469
Vlera kontabël e asetëve të nxjerra jashtë përdorimi	-	1,412,462
Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura)	(9,743,981)	104,413,090
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	15,661,964
<i>Fitimi i periudhës</i>	(9,805,277)	86,352,195

29. Transaksionet me palët e lidhura

Tepricat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
INTER-GAZ SHA	5,846,688	-	5,846,688	-
AV International Group	-	597,271,701	22,507	523,217,092
A&V Gas Distribution sha	226,008	466,000	226,008	466,000
PORT-CONSTRUCTION	-	-	-	128,099,894
SHPK	-	-	-	-
Piro Bare	4,218,244	-	-	194,771
TISCO GROUP shpk	-	125,391,848	-	-
	10,290,940	723,129,549	6,095,203	651,977,757

29. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
AV International Group	94,935,223	24,827,913	67,084,959	33,979,764
A&V Gas Distribution sha	-	-	-	388,333
PORT-CONSTRUCTION SHPK	-	-	2,054,979	233,365,142
TISCO GROUP shpk	549,349	108,134,708	-	-
	95,484,572	132,962,621	69,139,938	267,733,239

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

30. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 3 "gjykimet dhe vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare